

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë,

U deshën disa javë pritjeje dhe beteje për të ardhur Kryeministri. U deshën 5 javë për të folur për një çështje shumë të rëndësishme, e cila e ka bërë pis Shqipërinë, e cila e ka vendosur me shpatulla për muri Kryeministrin, për shkak të ndërhyrjes në shtyllën kryesore të funksionimit të demokracisë, duke shantazhuar opozitën, duke favorizuar oligarkët rusë, deri në cenimin e sigurisë kombëtare të Amerikës, thënë kjo nga disa media dhe eksponentë amerikanë. Rama erdhi dhe iku pa thënë asgjë për akuzën e rëndë ndaj tij. E ka kapur frika dhe paniku, ndaj braktisja që i bëri seancës sot, tregon se ai është i pashpresë. Jemi kthyer në një republikë bananesh dhe kuptohet që pas bananeve fshihen tonelata drogë që vijnë nga vendet e Amerikës së Jugut drejt Shqipërisë. Për shkak të tjetërsimit të votave, sot jemi kthyer në një shtet monist, në një shtet monopartiak, me një qeveri njëpartiake, me një pushtet vendor njëpartiak, me këshilla bashkiakë njëpartiake, madje me çdo institucione apo struktura që duhet të jenë autonome, njëpartiake. Gjatë këtyre 10 vjetëve, në mënyrë permanente “Rilindja” ka përqendruar të gjithë potencialin e saj politik, ekonomik, kriminal, korruptiv, kombëtar dhe ndërkombëtar në tjetërsimin e votës së lirë, në copëtimin dhe shantazhimin e opozitës, si dhe të çdo zëri kundër, edhe brenda mazhorancës. Në zgjedhjet e vitit 2013 patën një duzinë aleatësh me në krye Tadiçin, ku demonstuan orientimin internacionalist të tyre drejt aleancës socialisto-komuniste apo deri tek ajo serbo-ruse.

Të dashur qytetarë, Rama që në vigjilje hartoi strategjinë e mbijetesës së blerjes së votës dhe përdorimin e çdo veprimi antiligjor në tjetërsimin e votës së lirë të qytetarëve, në dëm të funksionimit të demokracisë dhe opozitës. Ishin zgjedhjet e pjesshme të vitit 2013 në Korçë, të cilat legalizuan blerjen e votës në mënyrë legale. Ishte reforma territoriale e njëanshme e vitit 2014, por edhe përdorimi i parave të pista, që në vitin 2015 prodhuan një pushtet vendor jashtë vullnetit të qytetarëve. Ishin vitet 2015 dhe 2016 kur “Rilindja” eksperimentoi hashashizimin e të gjithë Shqipërisë. Këtë gjë e bëri në mënyrë të qëllimshme, madje me bekimin e Kryeministrit, të ministrit të Brendshëm dhe të gjithë sejmënëve të policisë, të cilët shkonin merrnin haraçin për çdo rrënjë hashashi dhe nuk harronin t’u thoshin njerëzve që në zgjedhjet e vitit 2017 vota e tyre dhe e çdo eksponenti tjetër duhet të shkonte drejt “Rilindjes”. Ishin zgjedhjet e pjesshme të Dibrës, në vitin 2016, kur u eksperimentua se si mund të tjetërsoheshin votat. Madje për këtë çështje është edhe dosja 184, në të cilën Kryeministri është me zë dhe me figurë, si dhe Gjyknuri me eksponentë të tjerë. Kjo dosje nuk është mbyllur, por unë jam i sigurt që do të ketë reagime. Po ashtu, ju kujtohen shumë mirë fjalët e Gjyknurit, kur fliste për një tërmet, një tërmet lokal dhe këtë tërmet kjo qeveri arriti ta eksperimentojë në vitin 2017. Edhe për këtë ka një dosje të plotë. Eksperimenti i Dibrës doli me sukses në të gjithë Shqipërinë në vitin 2017, për shkak të tjetërsimit të votave. Për këtë çështje është dosja 338. Ky fenomen tashmë është kthyer në një tërmet kombëtar. Kryeministri nuk u mjaftua vetëm me kaq, por filloi të gjejë alternativa të tjera për t’u paraprirë zgjedhjeve të mëvonshme dhe fryrja e administratës publike, është mënyra kryesore që ka përdorur Kryeministri. Sot në Shqipëri 33% e

njerëzve punojnë në administratën publike. Kjo është një shifër rekord që ia kalon edhe Norvegjisë, edhe Suedisë, edhe Danimarkës, shtete të cilat po tentojnë të shkojnë nën 40 orë pune gjatë javës. Pavarësisht se mjaft shërbime janë privatizuar për shkak të koncesioneve dhe të PPP-ve, ne kemi një rekord të administratës publike, sepse administrata publike është patronazhiste, sot është edhe aktiviste. Madje, askush nuk guxon të mos votojë dhe jo vetëm që duhet të votojë vetë, por duhet të ketë edhe familjen dhe eksponentë të tjerë të lidhur me këta patronazhistë apo aktivistë, të cilët duhet t'ia japin votën kësaj qeverie. Një tjetër instrument që përdori kjo qeveri në këto vite është edhe presioni i drejtpërdrejtë ndaj medias. Ju kujtohet shumë mirë mbyllja e televizionit "Agon Channel", e cila i kushtoi jo pak, por 140 milionë euro buxhetit të shtetit shqiptar, vetëm për shkak të kapriçios së Kryeministrit, sepse ai televizion ishte një zë kundër kësaj qeverie. Ju kujtohet edhe sulmi që ka ndodhur së fundi kundër dy medieve të tjera, sekuestrimi i "Ora News" apo edhe shembja e resortit "Prestigj", të pronarit të televizionit "News 24". Kuptohet, këto veprime janë me një prapavijë politike për t'u paraprirë zgjedhjeve të radhës. Përdorimi i PPP-ve dhe i koncesioneve, tashmë edhe nga mjaft eksponentë ndërkombëtarë janë konsideruar si afera korruptive të certifikuara ndërkombëtarisht dhe që Kryeministri vazhdon t'i përdorë edhe sot, sepse i kanë dhënë sukses jo vetëm në aspektin korruptiv, por edhe në përdorimin e parave të pista për tjetërsimin e votave. Për të vazhduar me inceneratorët, për të cilët çdo shqiptar e di se sa korruptivë janë dhe jo vetëm korruptivë, por kanë edhe një impakt të jashtëzakonshëm në tjetërsimin e votave. Për të vazhduar me portalin e famshëm politik e-albania, i cili nuk është hakëruar për shkak të hakerave, por është bërë portal i Partisë Socialiste, madje avancimi ka vazhduar me portalin Aktivisti. Besoj se nuk ka ndonjë shqiptar që nuk është marrë përsipër nga patronazhistët apo aktivistët. Kryeministri nuk mjaftohet vetëm me këto iniciativa kombëtare, por është kthyer në një globalist. Madje përveç tërmetit të Dibrës të vitit 2016 dhe atij të vitit 2017, ka kaluar tek "tërmeti kombëtar i shantazhimit të opozitës", përdorimi i parave të kimit dhe të korrupsionit, siç është çështja "McGonigal". Kjo është për shkak të vullnetit të Kryeministrit, për të gjetur instrumente të tjera për tjetërsimin e votës. Janë dhënë miliona euro për këtë gjë dhe besoj se efekti i shantazhimit të opozitës është dukur, edhe në zgjedhjet e vitit 2019, edhe në ato të vitit 2021, madje është bërë shkak edhe për situatën në të cilën ndodhet opozita sot. Ka qenë një angazhim i drejtpërdrejtë i Kryeministrit, pasi jo më kot Kryeministri përmendet 14 herë në aktakuzën e ngritur. Po ashtu, dy personat "A" dhe "B", Neza dhe Duçka janë dy lobistë të certifikuar, janë bashkëpunëtorë me oligarkët rusë, konsulentë të kompanive kineze, madje edhe këshilltarë të Kryeministrit. Jo vetëm kaq, por Duçka e luan mjaft mirë këtë rol edhe me disa eksponentë të Bashkimit Europian (ku kam pasur mundësinë që ta shoh vetë), të cilëve u siguron hotele luksoze apo jahte buzë Adriatikut dhe buzë Jonit. Besoj se këto janë fakte të dhimbshme dhe të frikshme.

Për të vazhduar më tej te Skavica, si një instrument që Kryeministri, që nën petkun e përdorimit të amerikanëve do të ndërtojë një hidrocentral për ta zhbërë Dibrën, për të shpërngulur më shumë se 15 mijë banorë nga 35 fshatrat për ta zhbërë historinë e saj. Besoj se tërmeti i kësaj here nuk është si tërmeti i Dibrës, nuk është si tërmeti i vitit 2017, por tërmeti "McGonigal" është i pashpresë për Kryeministrin që kemi sot në detyrë.